



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KABINETI

### NJOFTIM PËR SHTYP

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të shoqërisë Reyl & Cie SA nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.

Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e përftimit të kontrollit të shoqërisë Reyl & Cie SA nga shoqëria Fideuram-Intesa Sanpaolo Private Banking S.p.A.

Sipas Marrëveshjes Kuadër dhe Marrëveshjes së Aksionarëve, palët janë:

**Pala Blerëse:** Fideuram - Intesa Sanpaolo Private Banking S.P.A është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Italisë. Fideuram ka objekt kryesor ofrimin e shërbimeve këshilluese financiare për të përmbushur nevojat e klientëve të saj.

Intesa Sanpaolo S.p.A është shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo Group, e cila është e pranishme në Shqipëri përmes filialit të zotëruar plotësisht prej saj Intesa Sanpaolo Bank Albania, SHA.

**Target:** Reyl & Cie SA është një shoqëri anonime e themeluar dhe që ekziston sipas ligjeve të Zvicrës. Reyl & Cie SA ka objekt kryesor ofrimin e shërbimeve në menaxhimin e pasurisë, menaxhimin e aseteve dhe shërbimet private të zyrës.

**Palët Shitëse:** Reyl & Cie Holding SA; RB Participations SA, shoqëri të themeluar sipas ligjeve të Zvicrës dhe Z. Thomas Fontaine, person fizik dhe aksionar i shoqërisë Reyl & Cie SA, ku zotëron 2% të kapitalit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**